



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 19 Prill 2023

Nr: 390

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMEVE NR. 1, 2, 17, NGA PARTIA
DEMOKRATIKE DHE DENONCIMEVE NR. 107, 108, 149, 169, 170, 176, 230 NGA
KOALICIONI PËR REFORMA, INTEGRIM DHE INSTITUCIONE TË KONSOLIDUARA NDAJ
KRYETARËVE TË DISA BASHKIVE DHE PERSONAVE PËRGJEGJËS PËR RAPORTIM TË
VEPRIMTARIVE PUBLIKE, PËR SHKELJE ADMINISTRATIVE, NË ZGJEDHJET PËR ORGANET
E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë 19 Prill 2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim denoncimin që u përket:

KËRKUES: Partia Demokratike
Koalicioni Për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)

NDAJ: Z. Gledian Llatja, kryetar i bashkisë Elbasan;
Z. Sotiraq Filo, kryetar i bashkisë Korçë;
Z. Edison Memolla, kryetar i bashkisë Rrogozhinë;
Z. Armando Subashi, kryetar i bashkisë Fier;
Zj. Eriselda Sefa, kryetar i bashkisë Lushnjë;
Z. Arif Tafani, kryetar i bashkisë Belsh;
Z. Tonin Vocaj, Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë;
Z. Shefqet Bullari, personi përgjegjës për raportim në bashkinë Elbasan.

OBJEKTI: 1- Përdorim i burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore
2- Mosraportim i veprimtarive publike

BAZA LIGJORE: Neni 19, paragrafi 1, shkronja “dh”, “f”, “n”, paragrafi 2, neni 91, 92 dhe 171 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar vendimi nr. 9, datë 09.03.2021 dhe vendimi nr. 9 datë 24.12.2020 “të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në portalin e denoncimeve në faqen zyrtare të KQZ-së, janë raportuar 3 (tre) denoncime nga Partia Demokratike, Dega Elbasan, 6 (gjashtë) indicie nga Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Integruara (KRIIK), dhe 1 (një) denoncim nga monitorues i Kontraktuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, të regjistruara pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me numëra unike ID.

Pala kërkuese kërkon hetimin e rasteve të mësipërme për shkeljet e mundëshme të dispozitave të Kodit Zgjedhor.

Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, pasi shqyrtova paraprakisht çështjet, vlerësoj se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ për secilën prej tyre.

Meqenëse në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve janë paraqitur 10 (dhjetw) indicie nga 3 (tre) subjekte të ndryshme dhe meqenëse objekti i shqyrtimit bazohet në të njëjtat fakte dhe bazë ligjore, në mbështetje të nenit 65, shkronja “ç” të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, u vendos shqyrtimi së bashku i këtyre indicieve.

Në vijim të procedurës administrative, filloi hetimi administrativ, duke kërkuar informacion në lidhje me pretendimet e denoncuesve. Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ka kërkuar nga institucionet publike nëpërmjet adresës së postës elektronike email, informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljeve të pretenduara.

Subjektet objekt i këtij vendimi kanë paraqitur pretendime si më poshtë vijon:

- 1- Bashkia Elbasan**, ka kryer 5 (pesë) veprimtari publike të regjistruara me nr. **1, 2, 17, 107, 108 dhe 149 ID**
- Denoncimin regjistruar me nr. **1 ID**, i raportuar në ndërfaqen “Denonco”, nga Partia Demokratike, Dega Elbasan, më datën 16.01.2023: “*Video e shpërndarë në rrjetet sociale*

Facebook nga kryetari i bashkisë Elbasan, Gledian Llatja në kundërshtim me ligjin në minutat 0:25 e në vazhdim kryetari i bashkisë jep mesazhe politike për zgjedhjet e 14 Majit 2023. Gjithashtu aktiviteti publik nuk rezulton të jetë i raportuar në ndërfaqe. Link “Bashkëbisedim me pensionistët e Elbasanit për Pakon e Madhe dhe punët e mira që na presin në 4 vitet e ardhshme. #TëBashkuarJoTëNdarë#ShqipëriaEArdhmjaJonë #SkaKohëPërPushim”.

Provati link:

<https://www.facebook.com/ljatja.gledian/videos/583592333590117/>

- Denoncimin regjistruar me nr. 2 ID, i raportuar në ndërfaqen “Denonco”, nga Partia Demokratike, Dega Elbasan, më datën 17.01.2023, ku pretendohet se “Aktivitet politik publik në cilësinë e kryetarit të bashkisë i shpërndarë masivisht në rrjete sociale Facebook/Instagram i cili ka për qëllim propagandimin në kundërshtim me Kodin Zgjedhor.

Bashkëlidhur këtij denoncimi janë dërguar provat link:

- 1- https://fb.watch/i4_l4YoqF5/
- 2- https://fb.watch/i4_l14is3/
- 3- https://fb.watch/i4_JxXuH8G/
- 4- https://fb.watch/i4_K0_GaGt/
- 5- https://www.facebook.com/ljatja.gledian/posts/pfbid02t5EëKdRr5mA52F785kDYvN_x3XTS4dxQ9aEs1S5tEv1Pqf4DReËTBuëSHAJJ1rve3l

Nëpërmjet shkresës nr. 202 prot., datë 17.01.2023, me lëndë “Kërkesë për informacion” i është kërkuar z. Gledian Llatja, kryetar i bashkisë Elbasan, informacion sqarues në lidhje me denoncimin nr. 1 ID, datë 16.01.2023. Referuar të dhënave të denoncimit nr. 2 ID, datë 17.01.2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka vlerësuar se veprimtaria publike e denoncuar është e njëjtë me denoncimin nr. 1 ID, datë 16.01.2023. Për arsytet e mësipërme, nëpërmjet shkresës nr. 232 prot, datë 18.01.2023, Kryetari të Bashkisë, z. Gledian Llatja është vënë në dijeni për këtë denoncim.

Bashkia Elbasan, nëpërmjet shkresës nr. 400/1 prot., datë 20.1.2023, e protokolluar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr. 202/1 prot., datë 23. 1.2023, ka informuar se “Aktiviteti i publikuar në llogarinë e facebook të z. Gledian Llatja në dt. 14.1.2023 (ditë e shtunë), është zhvilluar në kuadër të aktiviteteve me anëtarë dhe mbështetës të Partisë Socialiste të Shqipërisë të rajonit të Elbasanit, si funksionar i forcës politike të cilës i përkas. Kjo veprimtari nuk është publikuar në faqen e bashkisë Elbasan dhe nuk ka qenë në përmbushje të detyrave funksionale. Në vlerësimin tonë si dhe në referim të nenit 92, të Kodit Zgjedhor, si dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, ky aktivitet nuk përbën veprimtari publike pasi ka qenë në kuadrin e një bashkëbisedimi me anëtarët dhe mbështetësit e forcës politike në të cilën aderohet”.

Nëpërmjet shkresës nr. 435 prot., datë 26.1.2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve i ka dërguar për njohje Partisë Demokratike, Dega Elbasan shkresën me lëndë “Kthim përgjigje” me nr. 400/1 prot., datë 20.01.2023, të Bashkisë Elbasan, e protokolluar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr. 202/1 prot., datë 23.01.2023, që i përket denoncimeve me nr. 1 ID, datë 16.01.2023 dhe nr. 2 ID, datë 17.01.2023.

Për shkak të kompleksitetit të çështjes objekt shqyrtimi dhe sepse hetimi nuk ishte përfunduar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, nëpërmjet vendimeve nr. 176, datë 17.3.2023 dhe nr. 182, datë 20.03.2023, “Për zgjatjen e afatit të shqyrtimit administrativ të denoncimit të kryetarit të degës së Partisë Demokratike Elbasan ndaj z. Gledian Llatja, kryetar i bashkisë elbasan për shkelje administrative në kuadër të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”, ka vendosur zgjatjen e afatit me 60 (gjashtëdhjetë) ditë për shqyrtimin e denoncimit **nr. 1 dhe 2 ID**.

- **Denoncimin regjistruar me nr. 17 ID**, i raportuar në ndërfaqen “Denonco”, pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në datën 26.01.2023, ora 12: 27 PM, ku pretendohet se “Kryetari i Bashkisë Elbasan vazhdon shkel në mënyrë të përsëritur detyrimin për raportimin e veprimtarisë publike të institucionit 4 muaj përpara zgjedhjeve. Në kundërshtim me dispozitat e Kodit Zgjedhor dhe Vendimeve të KQZ-së. Z.Gledian Llatja vazhdon përdorimin e resurseve shtetërore për qëllime politike elektorale. Shkelja e denoncuar është e përsëritur vazhdimisht prej tij dhe kërkohet marrja e masave të menjehershme për ndalimin e këtyre shkeljeve dhe sanksionimin e tyre. Aktivitetet rezultojnë të gjitha të pa raportuara në KQZ-së. Në të gjitha aktivitetet ka përmbajtje politike elektorale në kundërshtim me nenin 92 të Kodit Zgjedhor dhe vendimin nr.9, të Komisionit Rregullator.

Bashkëlidhur këtij denoncimi janë dërguar provat link:

- 1- <https://www.facebook.com/ljatja.gledian/videos/2220446204828980>
- 2- <https://www.facebook.com/ljatja.gledian/posts/pfbid02bW9Lqttp3NcPhmxsD8XwK1FScYq1ZNPFRoJFK9mhG1SDhkzEavnzuEALcwWqLQ4zl>
- 3- <https://www.facebook.com/ljatja.gledian/posts/pfbid0XGy9v8QëHVdnH484Z1qhhjPghsU6tRvBAB8UNcM1EQymY3F8fpZTRaWMW9rdyaSQI>

Në vazhdim të hetimit administrativ, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, nëpërmjet shkresës nr. 433 prot., datë 26.01.2023, me lëndë “Kërkesë për informacion” i ka kërkuar z. Gledian Llatja, Kryetar i Bashkisë Elbasan, informacion sqarues në lidhje me denoncimin nr. 17 ID, datë 26.01.2023 dhe veprimtarinë publike të kryer nga ai me pjesëmarrje të publikut dhe deputetit z. Damian Gjijnuri.

Bashkia Elbasan, nëpërmjet shkresës nr. 616/1 prot., datë 30.01.2023, e protokolluar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr. 433/1 prot., datë 02.02.2023, ka informuar se:

Link 1“Më datë 23.01.2023, Kryetari i Bashkisë Elbasan, ka inspektuar punimet për rikonstruksionin e sheshit nr. 41 të lagjes “Beqir Dardha”, të qytetit të Elbasanit. Kjo veprimtari është raportuar në dt 18.01.2023, në faqen e KQZ-së. Lidhur me dy aktivitetet e tjera, për të cilat referon denoncimi, ju informojmë se : Në dt 22.01.2023 dhe 23.01.2023, Kryetari i Bashkisë ka zhvilluar një vizitë në dy subjekte private, që zhvillojnë aktivitetin e tyre në qytetin e Elbasanit. Të dy këto aktivitete nuk janë raportuar në KQZ, pasi nuk janë konsideruar si veprimtari publike, por si vizita personale të kryetarit të bashkisë. Referuar nenit 92, të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9/2020, të Komisionit Regulator ky aktivitet nuk përbën veprimtari publike pasi zhvillohet në një biznes privat, vetëm në praninë e punonjësve që ndodheshin në atë moment në ambientet e subjektit dhe pa praninë e mediave. Ky aktivitet nuk ka pasur në fokus të tij informimin e publikut në funksion të fushatës zgjedhore, as prezantim të politikave fiskale të Bashkisë dhe as në kontekst të buxhetimit me pjesëmarrje. Këto dy veprimtari janë pasqyruar vetëm në faqen personale të rrjetit social të kryetarit të bashkië dhe jo në faqen zyrtare apo në rrjetin social të institucionit të bashkisë. Theksojmë se kjo veprimtari nuk bie ndesh me asnjë parashikim të nenit 92, të Kodit Zgjedhor si dhe të vendiit nr. 9, datë 24.12.2020”.

- Denoncimin regjistruar me **nr. 107 ID**, i iniciuar nga Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK), ku pretendohet “Kryetari i bashkisë Elbasan z. Gledjan Llatja, së bashku me drejtuesin politik të qarkut Elbasan z. Damian Gjijnuri, si dhe deputeten e qarkut Elbasan zj. Dasantila Tahiraj ka zhvilluar bashkëbisedim me banorët e lagjes "Katund i vjetër" në njësinë administrative Shushicë. Ky aktivitet është postuar në faqet “Facebook” të kryetarit të bashkisë Elbasan z. Gledjan Llatja si dhe faqen “Facebook” të z. Gjijnuri, në datën 14 Shkurt 2023. Së pari, evidentohet se aktiviteti nuk është raportuar për t’u zhvilluar në ndërfaqen e raportimeve të KQZ dhe as si aktivitet ku merr pjesë dhe është prezent kryetari i bashkisë. Përgjatë fjalës së tij në këtë takim, kryetari i bashkisë evidentohet qartë që është thirrësi i takimit, duke folur ndër të tjera mbi punët e bëra nga bashkia në këtë zonë e përmendur me shembuj konkretë se çfarë është bërë dhe se cilat janë disa nga projektet për të ardhmen, duke e cilësuar në këtë mënyrë këtë aktivitet si një aktivitet institucional të Kryetarit të Bashkisë me komunitetin e kësaj zone. Së dyti, më shumë shqetësues mbetet fakti se në këtë takim janë mbajtur fjalime e janë kryer thirrje me kontekst elektoral. Kjo gjë evidentohet qartë, pavarësisht se konstatohet se video e postuar ka pësuar modifikime (prerje) dhe nuk është bruto. Takimi është pasqyruar edhe nga media Elbasani Neës TV: <https://elbasanineës.tv/gjijnuri-ne-elbasan-vota-per-ps-vote-per-vazhdimesine-e-gjerave-te-mira/>”

Nëpërmjet e-mail të datës 20.02.2023 me lëndë “Kërkesë për informacion” i është kërkuar bashkisë Elbasan, informacion sqarues në lidhje me denoncimin **nr. 107 ID** dhe nëpërmjet e-mail të datës 07.03.2023, jemi informuar nga se:

Data: 19 Prill 2023

Nr: 390
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj kryetarëve të disa bashkive dhe personave përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike”

“Në qytetin e Elbasanit, në dt. 14.02.2023 (ditë e martë), në orën 11.00, kryetari i bashkisë Elbasan, ka zhvilluar një takim me banoret e lagjes "Katund i vjetër", në njësinë administrative Shushicë, duke bashkëbiseduar me ta rreth problematikave që prekin këtë zonë. Të pranishëm të tjerë kanë qenë drejtuesi politik i qarkut Elbasan, z. Damian Gjijnuri dhe zj. Desantila Tahiraj, deputete e Qarkut Elbasan. Në referim të nenit 92 të Kodit Zgjedhor, si dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, ky aktivitet nuk përbën veprimtari publike pasi ka qenë në kuadrin e një bashkëbisedimi me elektoratin me natyrë politike, në të cilën kryetari i bashkisë ka marrë pjesë si funksionar politik. Kjo veprimtari është pasqyruar vetëm në faqen personale të rrjetit social të Kryetarit të Bashkisë dhe jo në faqen zyrtare apo në rrjetin social të Institucionit të Bashkisë. Theksojmë se kjo veprimtari nuk bie ndesh me asnjë parashikim të nenit 92 të Kodit Zgjedhor, si dhe të vendimit nr. 9, dt. 24/12/2020, Kreu II, Neni 3, pika 1 e tij.”

- Denoncimin regjistruar me **nr. 108 ID**, i iniciuar nga Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK) *“Kryetari i Bashkisë Elbasan z. Gledjan Llatja, bashkë me drejtuesin politik të Qarkut Elbasan z. Damian Gjijnuri ka zhvilluar bashkëbisedim me banorët në Labinot Mal. Ky aktivitet është postuar në faqen “Facebook” të kryetarit të bashkisë Elbasan z. Gledjan Llatja si dhe faqen “Facebook” të z. Gjijnuri, në datën 15 Shkurt 2023. Së pari, evidentohet se aktiviteti nuk është raportuar për t’u zhvilluar në ndërfaqen e raportimeve të KQZ dhe as si aktivitet ku merr pjesë dhe është prezent kryetari i bashkisë. Përgjatë fjalës së tij në këtë takim, kryetari i bashkisë evidentohet se është thirrësi i takimit, duke folur ndër të tjera mbi punët e bëra nga bashkia në këtë zonë e përmendur me shembuj konkretë se çfarë është bërë dhe se cilat janë disa nga projektet për të ardhmen, duke e cilësuar në këtë mënyrë këtë aktivitet si një aktivitet institucional të Kryetarit të bashkisë me komunitetin e kësaj zone. Së dyti, më shumë shqetësues mbetet fakti se në këtë takim janë mbajtur fjalime e janë kryer thirrje me kontekst elektoral. Kjo gje evidentohet qartë, pavarësisht se konstatohet se video e postuar ka pësuar modifikime (prerje) dhe nuk është bruto.”*

Nëpërmjet e-mail të datës 20.02.2023 me lëndë “Kërkesë për informacion” i është kërkuar bashkisë Elbasan, informacion sqarues në lidhje me denoncimin **nr. 108 ID** dhe nëpërmjet e-mail të datës 07.03.2023, jemi informuar se: *“Në qytetin e Elbasanit, në dt. 15.02.2023 (ditën e mërkurë), në orën 12.00, kryetari i bashkisë Elbasan dhe drejtuesi politik i qarkut z. Damian Gjijnuri kanë zhvilluar një takim me banorët e Njesisë Administrative Labinot Mal, duke bashkëbiseduar me ta rreth problematikave që prekin këtë komunitet. Ky aktivitet ka qenë në kuadrin e një bashkëbisedimi me elektoratin me natyrë politike, në të cilën kryetari i bashkisë ka marrë pjesë si funksionar politik. Kjo veprimtari është pasqyruar vetëm në faqen personale të rrjetit social të kryetarit të bashkisë dhe jo në faqen zyrtare apo në rrjetin social të Institucionit të Bashkisë. Theksojmë se kjo veprimtari nuk bie ndesh me asnjë parashikim të nenit 92 të Kodit Zgjedhor, si dhe të vendimit nr. 9, dt. 24.12.2020, Kreu II, Neni 3, pika 1 e tij”.*

Në vijim të hetimit administrativ për denoncimet nr. **1, 2, 17, 107, 108 ID**, bashkia Elbasan është njoftuar për zhvillimin e seancës publike të Komsioinerit Shtetëror të Zgjedhjeve, më datë 8.3.2023, por nuk morwn pjesw përfaqësues të institucionit.

Në përfundim të hetimit administrativ, pas shqyrtimit të pamjeve filmike dhe provave shkresore të administruara për denoncimet nr. 2, 107, 108 ID, u vlerësua se natyra e aktiviteteve të kryera nga z. Llatja, janë të karakterit politik dhe nuk janë veprimtari publike të institucionit të bashkisë. Këto aktivitete janë zhvilluar në kuadër të aktiviteteve me anëtarë dhe mbështetës të Partisë Socialiste të Shqipërisë. Kryetari i bashkisë, si funksionar i partisë ku aderohet, mund të jetë pjesëmarrës në aktivitete të cilat organizohen nga kjo forcë politike dhe të shprehë mendimet e veta. Këto veprimtari nuk kanë detyrimin për raportim në ndërfaqen e raportimeve pasi nuk janë zhvilluar nga z. Llatja si kryetar bashkie. Përsa më sipër, rezultoi se veprimtaria objekt denoncimi, nuk përmban fakte dhe rrethana që përfshihen në fushën e zbatimit të ndalimeve të përcaktuara në nenin 91, dhe 92 të Kodit Zgjedhor si dhe të nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

- Denoncimin regjistruar me **nr. 149 ID** iniciuar nga Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK) "*Bashkia Elbasan më datë 28.02.2023, ka zhvilluar një veprimtari publike të cilën e ka njoftuar paraprakisht në ndërfaqen e KQZ-së, në datën 22.02.2023 <https://aktivitete.kqz.gov.al/2023/02/22/inspektim-i-punimeve-10/>. Në këtë aktivitet ka marrë pjesë edhe Drejtuesi Politik i Qarkut Elbasan, deputet i Qarkut Vlorë dhe Sekretar i Përgjithshëm i Partisë Socialiste z. Damian Gjikhuri.*

Njoftimi për zhvillimin e kësaj veprimtarie publike është postuar në faqen zyrtare të Bashkisë Elbasan (), ku në postimin e bërë në linkun <https://ëëë.facebook.com/elbasanbashkia/videos/1688280371603759>, paraqitet kjo përmbajtje: "Po mbajmë fjalën e dhënë për komunitetin e Njesisë 1 Tani rruga "Tomorr Domi" do të japë një tjetër lehtësi në qarkullim për bizneset e zonës së ish Konservimit dhe familjeve të atij blloku pallatesh #ElbasaniQëDuam".

Gjithashtu foto të këtij aktiviteti janë postuar edhe në faqen zyrtare të z. Gjikhuri (<https://www.facebook.com/photo?fbid=745951093566945&set=pcb.745956430233078>), ku postimi i bërë ka këtë përmbajtje: "Asfaltimi dhe sistemimi i plotë i rrugës "Tomorr Domi" si edhe rehabilitimi i sheshit të pallateve në Njesisë nr. 1 të qytetit është një tjetër dëshmi e punëve transformuese të bashkisë për Elbasanin. Investimi, një kërkesë e kahershme, u vjen në ndihmë mbi 300 banorëve të kësaj lagjeje. Falë vizionit dhe përkushtimit të Gledit, bashkia po vijon ndërhyrjet në të gjitha lagjet e qytetit nga qendra në periferi. Nga ana tjetër qeveria vazhdon vëmendjen e shtuar ndaj Elbasanit me investimet e mëdha sikurse janë 'Korridori 8', 'Bypass-i' i ri i Elbasanit, "Automotoparku", shëtitorja anash lumit Shkumbin që do jetë një hapësirë fantastike rekreative. Qytetarët e Elbasanit dinë ta bëjnë dallimin mes atyre që kërkojnë t'i përdorin për interesa personale e politike dhe atyre që punojnë e përkujdesen për ta."

Nëpërmjet e-mail të datës 06.03.2023 me lëndë "Kërkesë për informacion" i është kërkuar bashkisë Elbasan, informacion sqarues në lidhje me denoncimin **nr. 149 ID** dhe nëpërmjet

e-mail të datës 09.03.2023, jemi informuar se: “ Më dt. 28.02.2023, ora 10:00, kryetari i bashkisë Elbasan, ka inspektuar punimet për rinstruksion të rrugëve “Tomorr Domi” dhe “Hysen Peni”, të qytetit të Elbasanit. Në këtë inspektim kryetari i bashkisë është shoqëruar nga drejtuesi politik i qarkut Elbasan z. Damian Gjijnuri. Kanw qënë prezent qytetarë të rastësishëm banorë të lagjes. Kjo veprimtari është raportuar në dt. 22.02.2023, në faqen e KQZ –së, nga personi raportues.”

Pas verifikimit të të dhënave, provave dhe fakteve, vlerësoj se aktiviteti është raportuar konform parashikimeve të nenit 92, të Kodit Zgjedhor. Gjithashtu, aktiviteti i kryer nuk përbën veprimtari të ndaluar në kuptim të nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, pasi z. Gledian Llatja ka qënë në kryerjen e detyrave të tij funksionale. Nga verifikimi i rrethanave dhe fakteve dhe nga këqyrja e materialeve, nuk rezulton që në këtë aktivitet janë mbajtur deklarime apo thirrje elektorale nga asnjë prej pjesëmarrësve. Pjesëmarrja e deputetit jo domosdoshmërisht e kthen aktivitetin e një institucioni publik, në një aktivitet elektoral. Fjalimi me përmbajte elektorale, logot, materialet propagandistike dhe çdo element tjetër, që mbart mesazhe elektorale, janë elementë që e kthejnë aktivitetin në të tillë. Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezulton se objekti rast hetimi pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ndaj bashkisë Elbasan, nuk përbën shkelje të neneve 91 dhe 92, të Kodit Zgjedhor dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator.

2- **Bashkia Korçë** ka zhvilluar 1 (një) veprimtari publike, e regjistruar me **nr. 230 ID**, për të cilën pretendohet në raportin e monitorimit, si vijon:

- Denoncimi **nr. 230 ID**, “Z. Sotiraq Filo, kandidat për kryetar bashkie dhe kryetari aktual promovon ne rrjete sociale ndihma ushqimore të paleve të treta duke i vendosur logon e bashkisë. Punonjësit e shpërndarjes janë po ashtu punonjësit e bashkisë Korçë.”

Më datë 31.3.2023, bashkisë Korçë, i është kërkuar informacion në lidhje me indiciet e marra nga raporti i monitorimit, nëpërmjet adresës elektronike dhe jemi informuar më datë se:

“- Fondet vijnë nga fondacioni “Care for Albania”, me qendër në Chicago SHBA.

- Pranë bashkisë Korçë në vitin 2022 u hap Zyra e Migracionit dhe Diasporës. Një nga qëllimet e kësaj zyre është koordinimi i ndihmave për shtresat në nevojë nga donacione të ndryshme që ofron diaspora kudo në botë. Bashkëpunimi mes “Care for Albania” dhe Zyrës së Migracionit dhe Diasporës të Bashkisë Korçë ka nisur që në vitin 2022. Faza e parë e bashkëpunimit u mbyll në muajin dhjetor të vitit 2022 me ofrimin e ndihmave për fëmijët me aftësi ndryshe me materiale të nevojshme të cilat mungonin, të dhuruara për këtë qendër. Aktiviteti i zhvilluar ishte një nga fazat e këtij bashkëpunimi, i cili ka vazhdimësi edhe në të ardhmen. Logoja është vendosur pasi bashkia Korçë ka bërë koordinimin midis shtresave në nevojë dhe fondacioneve që ofrojnë ndihma për këto shtresa.

- Veprimtaria është zhvilluar në datën kur është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së.

- Punonjësi që ka shpërndarë ndihmat ushqimore: Kostandin Shirgu, Pozicioni Korrier”

Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezultoi se veprimtaria e raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është vlerësuar si veprimtari e lejuar për t'u zhvilluar. Punonjësi, Kostandin Shirgu, me shpërndarjen e ndihmave ushqimore ka qenë në përmbushje të detyrimeve si korrier në bashkinë Korçë. Veprimtaria e mësipërme rezultoi e raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me datë 20.03.2023. Përsa më sipër, objekti rast hetimi pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ndaj bashkisë Elbasan, nuk përbën shkelje të neneve 91 dhe 92, të Kodit Zgjedhor dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator.

3- Bashkia Rrogozhinë, ka raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 1 (një) veprimtari publike, të regjistruara me **nr. 169 ID**, për të cilat pretendohet si vijon:

- Denoncimin regjistruar me **nr. 169 ID** *“Ditën e hënë, në datë 6 mars, Kryetari i Bashkisë Rrogozhinë ka postuar në faqen e vet në Facebook: Gjatë inspektimit të punës për sistemimin e kanalit Peqin-Kavajë në njësinë administrative Gosë. Bashkia Rrogozhinë” Një postim në lidhje me këtë aktivitet ka ndarë në faqen e vet në Facebook edhe deputeti Etjen Xhafaj, i pranishëm në inspektim, postim i cili ka përmbajtjen e mëposhtme: Gosë-Kanali i vaditjes Peqin-Kavajë është një nga pikat kyçe për bujqësinë dhe për komunitetin e zonës.*

Me Edisonin dhe banorë për të parë nga pranë punimet për sistemimin dhe pastrimin e kanalit. #ShqiperiaEArdhmjaJone#SkaKohëPërPushim #VazhdojmëBashkë. Ky aktivitet është raportuar nga Bashkia Rrogozhinë për t'u kryer pikërisht në këtë datë. Qartas, në këtë inspektim të punimeve publike, kryetari i bashkisë Rrogozhinë, Memolla, ka qenë i shoqëruar nga deputeti Xhafaj.”

Më datë 13.3.2023, bashkisë Rrogozhinë i është kërkuar informacion në lidhje me indiciet e marra, nëpërmjet adresës elektronike dhe nëpërmjet shkresës nr. 991 prot., datë 15.3.2023, administruar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr. 1750 prot., datë 17.3.2023, ka sqaruar se: *“Bashkia Rrogozhinë ka raportuar në datën 1.3.2023, në faqen zyrtare 'aktivitete-kqz' të dhënat e postimit në lidhje me datën, orën, organizatorin, tematikën e aktivitetit, pjesëmarrjen dhe mediatizimin. Bashkangjitur po ju dërgojmë raportimin e bërë nga bashkia Rrogozhinë në faqen e KQZ si dhe postimin në faqet zyrtare të rrjeteve sociale të kryetarit të bashkisë Rrogozhinë z. Edison Memolla.*

4- Bashkia Fier, ka raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 1 (një) veprimtari publike, të regjistruara me **nr. 170 ID**, për të cilën pretendohet si vijon:

- Denoncimin regjistruar me **nr. 170 ID**, *“Ditën e hënë, datë 6 mars, deputeti dhe drejtuesi politik i Partisë Socialiste për Qarkun Fier, z. Taulant Balla ka postuar në faqen e vet në Facebook: “Fier Në Kompleksin e përpunimit të mishit "Semanjaku", një investim sipas standardeve më të mira europiane. Me një cikël të mbyllur prodhimi, ky kompleks është një nga investimet më të mëdha në këtë fushë në Shqipëri*

Data: 19 Prill 2023

Nr: 390
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj kryetarëve të disa bashkive dhe personave përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike”

#TëBashkuarJoTëNdarëShqipëriaEArdhmjaJonë #SkaKohëPërPushim” Ky postim është ndarë edhe në faqen e kryetarit të Bashkisë Fier, z. Armando Subashi: “FierNë Kompleksin e përpunimit të mishit "Semanjaku", një investim sipas standardeve më të mira europiane. Me një cikël të mbyllur prodhimi, ky kompleks është një nga investimet më të mëdha në këtë fushë në Shqipëri #TëBashkuarJoTëNdarë #ShqipëriaEArdhmjaJonë #SkaKohëPërPushim” Ky aktivitet i Bashkisë Fier është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së në datën 18.02.2023, për tu zhvilluar më datë 24.02.2023. Qartas, sipas këtyre postimeve Kryetari i Bashkisë Fier dhe Deputeti Balla, njëkohësisht Drejtues Politik i PS për Qarkun Fier kanë marrë pjesë së bashku në një aktivitet publik të Bashkisë Fier.”

Më datë 13.3.2023, bashkisë Fier i është kërkuar informacion në lidhje me indiciet e marra, nëpërmjet adresës elektronike, dhe më datë 16.3.2023 bën me dije se përsa i përket aktivitetit objekt i denoncimit nr. **170 ID** “ju informojmë se është zhvilluar në ditën dhe orën e raportuar në ndërfaqen KQZ. Nëse i referohemi raportimit të bërë shihet qartë se nuk kemi të bëjmë me një aktivitet publik, por me një vizitë të qytetarit të parë të bashkisë në disa sipërmarrje private ku qëllimi është njohja nga afër e punës, produktit, arritjeve dhe sfidave, kjo me synim krijimin e një panorama më të plotë të situatës së sipërmarrjeve private kryesisht në fushën e agropërpunimit. Vizitat kanë nisur nga fabrika e miellit “Mokra” në orën 11:00, për të vazhduar me vizitën në “Mobilerinë XG” në 11:30, më pas në thertoren “Semanjaku” në orën 12:00 dhe kanë përfunduar me vizitën në pikën e grumbullimit të drithërave të fermerit Alfred Etsi në Kallm i Vogël në orën 13:00. Sikurse është raportuar, këto kanë qenë thjesht vizita ku nuk ka patur asnjë media dhe as ka qenë një aktivitet i hapur për pubikun. Duke patur parasysh qëllimin e këtyre vizitave (e lartëcituar), ka qenë thjesht një bashkëbisedim miqësor me përfaqësuesit e këtyre sipërmarrjeve në lidhje me ecurinë e aktivitetit të tyre. Këto vizita nuk kanë patur si qëllim as të informojnë këta persona apo grup personash me ndonjë mundësi mbështetjeje, as me ofrimin e ndonjë lehtësie nga ana e qeverisjes vendore apo qëndrore, apo të informojë/ promovojë ndonjë akt politik.

Përsa i përket publikimit të këtyre vizitave, ato janë publikuar në rrjetin social facebook të Armando Subashi. Pasqyrimi i aktiviteteve në këtë rrjet social bëhet sipas mundësisë dhe hapësirës. Asnjëherë nuk kemi thënë që do i pasqyrojmë në kohë reale. Jo vetëm këtë aktivitet, por përgjithësisht nuk e bëjmë këtë gjë. Në praktikën e punës ne i pasqyrojmë aktivitetet, takimet kur të shikojmë mundësinë sipas një grafiku të përcaktuar në bazë të ndjekshmërisë dhe shikueshmërisë në rrjetet sociale...”

5- Bashkia Belsh, ka raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 1 (një) veprimtari publike, **të regjistruar me nr. 168 ID**, për të cilën pretendohet si vijon:

- Denoncimi **nr. 168 ID** “Ditën e enjte, datë 9 mars, deputeti dhe drejtuesi politik i Partisë Socialiste për Qarkun Elbasan, z. Damian Gjijnuri ka postuar në faqen e vet në Facebook: “Me

Arif Tafanin në Belsh ku ndoqëm nga afër punimet që po kryhen në rrugën që lidh qytetin me fshatin Stanaj. Investimi përfshin sistemimin, shtrimin me asfalt të katër kilometrave rrugë dhe pajisjen e saj me të gjithë sinjalistikën e nevojshme. Taksat e qytetarëve, Arifi si kryebashkiak model, ka ditur ti përkthejë në investime për ta. Ndryshimi në të gjithë zonën e Dumresë është i prekshëm kudo ndaj në 14 maj qytetarët e Belshit e kanë të qartë zgjedhjen e tyre për më shumë punë transformuese në interes të tyre. #TëBashkuarJoTëNdarë #ShqipëriaeArdhmjaJonë #SkaKohëPërPushim” Ky postim është ndarë edhe në faqen e kryetarit të Bashkisë Belsh, z. Arif Tafani. Një aktivitet i bashkisë Belsh në këtë zonë dhe që përfshin inspektim rruge është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së për në datën 3 mars dhe duket të jetë i njëjti. Qartas, sipas këtyre postimeve kryetari i bashkisë Belsh, z. Tafani, dhe Deputeti Gjijnuri, njëkohësisht Drejtues Politik i PS për Qarkun Elbasan kanë marrë pjesë së bashku në një inspektim të punimeve publike”.

Më datë 13.3.2023 bashkisë Belsh i është kërkuar informacion në lidhje me indiciet e marra, nëpërmjet adresës elektronike, por nuk i është përgjigjur kërkesës.

Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ, rezultoi se veprimtaritë e raportuara në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për denoncimet **nr. 168, 169 dhe 170 ID**, janë vlerësuar si veprimtari të lejuara për t’u zhvilluar.

Të ndodhur në kushtet që, veprimtaritë e kryera nga **bashkia Belsh, Rrogozhinë dhe Fier**, nuk përbëjnë veprimtari të ndaluara në kuptim të nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, vlerësoj se aktivitetet e kryera kanë qenë në përmbushje të detyrave funksionale të kryetarëve të bashkisë. Pjesëmarrja e deputetit jo domosdoshmërisht e kthen aktivitetin e një institucioni publik, në një aktivitet elektoral. Fjalimi me përmbajtje elektorale, logot, materialet propagandistike dhe çdo element tjetër, që mbart mesazhe elektorale, janë elementë që e kthejnë aktivitetin në të tillë. Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezulton se objekti rast hetimi pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, nuk përbën shkelje të neneve 91 dhe 92, të Kodit Zgjedhor dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator.

6- Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, nuk ka raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 1 (një) veprimtari publike, **të regjistruara me nr. 176 ID**, për të cilën nga denoncuesi "Partia Demokratike e Shqipërisë" pretendohet si vijon:

- Denoncimi **nr. 176 ID** "Në datën 08.03.2023, zj. Etilda Gjonaj me detyrë "Deputet" i Partisë Socialiste të Shqipërisë, ka publikuar në rrjetet sociale një status dhe foto në ambientet e zyrave të Policisë së Shtetit, pranë Komisarariatit nr. 2 Tiranë, takimin e mbajtur me strukturat e këtij Komisaritati, duke i bashkëlidhur fotos dhe statusit të saj sloganet elektorale të Partisë Socialiste të Shqipërisë (Gruaja PS), veprim ky që tregon qartazi përdorimin e detyruar në fushatë zgjedhore të administratës shtetërore brenda orarit të punës për veprimtari dhe

aktivitete për qëllime zgjedhore, në kundërshtim me nenin 3, pika 1.3/c dhe të nenit 6, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve."

Më datë 16.3.2023 Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë i është kërkuar informacion në lidhje me indiciet e marra, nëpërmjet adresës elektronike.

Më datë 17.3.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit bën me dije se "Znj. Etilda Gjonaj si Deputete e Kuvendit të Shqipërisë, me rastin e festës së 8 Marsit "Ditës Ndërkombëtare të Grave", në vazhden e takimeve të organizuara ditën e 8 Marsit, ka ndaluar dhe në Komisaratin e Policisë Nr.2 Tiranë, ku ka uruar punonjëset e policisë "Gëzuar 8 Marsin" dhe u ka dhuruar nga një trëndafil në respekt për kryerjen e detyrës së tyre fisnike. Prania e Deputetes Znj. Etilda Gjonaj në ambientet e Komisarariatit të Policisë Nr.2 Tiranë, është e bazuar në pikën 2, të nenit 44 "Hyrja e personaliteteve", të Rregullores së Policisë së Shtetit, miratuar me VKM nr.750, datë 16.09.2015, e ndryshuar.

Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezultoi se pjesëmarrja e zj. Gjonaj, në këtë aktivitet lidhet me detyrat funksionale të deputetit.

Për shkak të tematikës dhe natyrës së veprimtarisë, vlerësojmë se veprimtaria e mësipërme nuk ka pasur detyrimin për raportim. Në këto kushte, vlerësoj se duhet të pushohet hetimi administrativ sepse objekti rast denoncimi, nuk përmban rrethana që mund të përfshihen në nenin 91 të Kodit Zgjedhor.

7- Bashkia Lushnje, ka raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 1 (një) veprimtari publike, **të regjistruar me nr. 171 ID**, për të cilën pretendohet si vijon:

- Denoncimi **nr. 171 ID**, "Ditën e premtë, datë 3 mars, deputeti dhe drejtuesi politik i Partisë Socialiste për Qarkun Fier, z. Taulant Balla ka postuar në faqen e vet në Facebook #punëjollafe Lushnje Ka përfunduar puna për asfaltimin e rrugës në Lumth, Njësia Administrative #Kolonjë. Premtim i mbajur. #TëBashkuarJoTëNdarë#ShqipëriaEArdhmjaJonë#SkaKohëPërPushim
Ky postim është ndarë edhe në faqen e kryetares së Bashkisë Lushnje, znj. Eriselda Sefa "Në punë, Me Njerëzit Për Njerëzit! Nga rruga e asfaltuar në Lumth (Kolonjë)" Ky aktivitet i Bashkisë Lushnje është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së për në datën 28 shkurt 2023. Qartas, sipas këtyre postimeve Kryetarja e Bashkisë Lushnje dhe Deputeti Balla, njëkohësisht Drejtues Politik i PS për Qarkun Fier kanë marrë pjesë së bashku në një aktivitet publik të bashkisë Lushnje."

Më datë 13.3.2023 bashkisë Lushnje i është kërkuar informacion në lidhje me indiciet e marra, nëpërmjet adresës elektronike dhe më datë 16.3.2023, bashkia Lushnje bën me dije se "Ky aktivitet i bashkisë Lushnje është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së për në datën 28 Shkurt 2023 dhe është postuar në faqen e bashkisë Lushnje në datën 28 Shkurt 2023. Raportimi nga ana jonë në KQZ është kryer brenda afateve ligjore. Ju informojmë së vizita e kryetares se bashkisë Lushnje dhe drejtuesit

politik është zhvilluar në datën 28 Shkurt, rreth orës 10:00, me pjesëmarrjen e fotografit të institucionit tonë, pa gazetarë prezent, dhe është postuar më pas në faqen e kryetares në datë 3 Mars, bëjmë me dije se për shkak të postimeve të shumta që publikohen në facebook gjatë ditës, foto të aktiviteteve mund të postohen edhe më vonë sesa dita e realizimit të tyre në inspektim, terren apo aktivitet. Aktiviteti është inspektim të punimeve, pa fjalime dhe pa publik prezent, rutinë e punëve të drejtueses së institucionit.”

Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezultoi se veprimtaria e raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është vlerësuar si veprimtari e lejuar për t’u zhvilluar.

Të ndodhur në kushtet që, veprimtaria e kryera nuk përbën veprimtari të ndaluar në kuptim të nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, vlerësoj se veprimtaria publike e kryer ka qenë në përmbushje të detyrave funksionale të kryetarit të bashkisë Pjesëmarrja e deputetit jo domosdoshmërisht e kthen aktivitetin e një institucioni publik, në një aktivitet elektoral. Përsa më sipër, objekti rast hetimi pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ndaj bashkisë Rrogozhinë, nuk përbën shkelje të neneve 91 dhe 92, të Kodit Zgjedhor dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, paragrafi 1, shkronja “dh”, “f”, “n”, paragrafi 2, 91 dhe 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit, 23 dhe 60 e vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimit nr.9/2021, të Komisionit Rregullator në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve,

V E N D O S:

1. Pushimin e procedimit administrativ ndaj:

- a. z. Gledian Llatja, kryetar i bashkisë Elbasan;
- b. z. Sotiraq Filo, kryetar i bashkisë Korçë;
- c. z. Edison Memolla, kryetar i bashkisë Rrogozhinë;
- d. z. Armando Subashi, kryetar i bashkisë Fier;
- e. zj. Eriselda Sefa, kryetar i bashkisë Lushnjë;
- f. z. Arif Tafani, kryetar i bashkisë Belsh;
- g. z. Tonin Vocaj, Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë;
- h. z. Shefqet Bullari, personi përgjegjës për raportim në bashkinë Elbasan.

2. Moskonstatimin e shkeljes administrative.

3. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet postës elektronike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI